



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2010

01 janar 2010 - 31 dhjetor 2010

**Shkurt 2011
Prishtinë**

P Ë R M B A J T J A

HYRJE	3
1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.....	4
2. Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë gjatë vitit 2010	5
2.1. Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010.....	6
2.2. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010	7
2.3. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas burimeve të financimit.....	9
2.4. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas llojit të prokurimit.....	10
2.5. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas vlerës së prokurimit.....	13
2.6. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas procedurave të prokurimit	15
2.7. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas llojit dhe procedurave të prokurimit.....	19
2.8. Kontratat e nënshkruara dhe anekskontratat gjatë vitit 2010.....	20
2.9. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas operatorëve ekonomik.....	21
2.10. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas afatit kohor për publikim.....	21
2.11. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas kriterëve për dhënie.....	22
2.12. Numri mesatar i tenderuesëve që kan konkuruar për një prokurim gjatë vitit 2010.....	22
2.13. Vlera e kontratave të nënshkruara në raport me BPV në Kosovë gjatë vitit 2010.....	23
2.14. Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara në Kosovë nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2010.....	24
2.15. Kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 2.000.000,00 nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2010.....	29
3. Aktivitetet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.....	31
4. Rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.....	36
5. Aneks: Shpenzimet Buxhetore të KRPP-së për vitin 2010.....	37

H Y R J E

Duke u bazuar në Nenin 87.2.9 të Ligjit për Prokurim Publik, Nr. 03/L-241, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik përgatit dhe ia dorëzon Qeverisë e Kuvendit të Kosovës Raportin vjetor, në të cilin i analizohen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë, për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, si dhe përmirësimin e Ligjit për Prokurim Publik sipas nevojës. Ky raport duhet t'i dërgohet Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës më së voni deri në fund të muajit shkurt të vitit vijues.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke u bazuar në kërkesën e nenit të lartshënuar të Ligjit për Prokurim Publik, me kohë e ka përgatitur Raportin vjetor për vitin 2010 dhe ua dërgon Qeverisë së Kosovës si dhe Kuvendit të Kosovës.

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik Nr. 03/L-241, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 1 janar 2010 - 31 dhjetor 2010.

Përgatitja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 87.2.9 të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet t'i grumbullojë, t'i analizojë dhe t'i publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna publike.

Është ky viti i gjashtë me radhë që KRPP-ja përgatit një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë dhe ta kompletojë atë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2010.

Ky raport do të jetë mjaft i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit. Raporti do të jetë i dobishëm edhe për donatorët e ndryshëm që mendojnë të investojnë në të ardhmen në Kosovë, pasi që, duke u bazuar në të dhënat e raportit, mund të konstatohet se 85,47 % e buxhetit për prokurime publike në Kosovë gjatë vitit 2010 janë shpenzuar përmes procedurës së hapur, që njihet si procedura më transparente në prokurimin publik.

1. KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, Nr. 03/L-241, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgjegjësinë kryesore për zhvillimin dhe funksionimin e përgjithshëm të rregullave të prokurimit publik dhe të sistemit të prokurimit publik të Kosovës përmes ushtrimit të autoritetit, kompetencave, funksioneve dhe përgjegjësi të cilat i janë dhënë shprehimisht me këtë ligj.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgjegjësinë dhe autoritetin për:

- përgatitjen dhe publikimin e rregullave të hollësishme të prokurimit publik të cilat kanë për qëllim implementimin e këtij ligji nga autoritetet kontraktuese, duke përfshirë rregullat për përdorimin dhe ushtrimin e secilës procedure të prokurimit të përcaktuar në nenet 33 – 37 të këtij ligji. Këto rregulla duhet të jenë në pajtim të plotë me parimet e përcaktuara në këtë ligj dhe me kërkesat e aplikueshme të BE-së lidhur me prokurimin;
- përgatitjen dhe publikimin e doracakëve (manualeve) të prokurimit, udhëzuesve, formularëve standard të prokurimit dhe modeleve të kontratave dhe kushteve të kontratës në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik. KRPP duhet të sigurojë modelet e kontratave dhe kushteve të kontratës të mos përfshijnë elemente të detyrueshme, përveç nëse këto elemente janë qartësisht të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e kontratës me këtë ligj. KRPP do të sigurojë që këto modele të kontratave dhe kushteve të kontratës të mos pengojnë autoritetet kontraktuese që të përshtatin një kontratë publike me praktikën e zakonshme të përcaktuara në paragrafin 2. të nenit 12 të këtij ligji;
- të rrisë vetëdijen e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik mbi legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e përcaktuara në këtë legjislacion;
- të ofrojë ndihmë teknike për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të prokurimit publik;
- të nxjerrë dhe publikojë interpretime administrative me shkrim për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik lidhur me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të prokurimit publik;
- të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese;
- të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna;
- në bashkëpunim me APP, të përgatisë dhe dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për çdo vit një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik. Ky raport dorëzohet jo më vonë se në fund të Shkurtit të vitit vijues kalendarik
- të krijojë dhe mirëmbajë një faqe informative në internet që i ofron publikut qasje të pa kufizuar në (i) këtë ligj dhe gjithë legjislacionin sekondar të nxjerrë sipas këtij ligji, (ii) interpretimet dhe dokumentet e përcaktuara në këtë nen, dhe (iii) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik;

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik udhëhiqet nga Bordi, që përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

2. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2010

Duke u bazuar në Nenin 87.2.14 të Ligjit për Prokurim Publik, Nr. 03/L-241, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të përgatisë dhe të mbajë një listë të plotë të gjitha autoriteteve kontraktuese në Kosovë, të cilat janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin për Prokurim Publik. Më 1 janar 2010 në Kosovë kanë ekzistuar 152 autoritete kontraktuese, kurse më 31 dhjetor 2010 numri i këtyre autoriteteve kontraktuese është shtuar në 161.

Përmes raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2011, i kanë dërguar në mënyrë elektronike, departamenti i TI-së ka përgatitur Raportin përmbledhës vjetor për të gjitha prokurimet publike të zhvilluara në Kosovë gjatë vitit 2010.

Nga gjithsejt 161 autoritete kontraktuese sa kanë ekzistuar në Kosovë në fund të vitit 2010, 158 autoritete kontraktuese me kohë i kanë dorëzuar raportet vjetore, 3 autoritete kontraktuese fare nuk i kanë dërguar raportet vjetore. Autoritetet kontraktuese, të cilat nuk i kanë dorëzuar raportet vjetore, janë tri komuna nga pjesa veriore e Kosovës si Komuna e Zveqanit, e Zubin Potokut dhe e Leposaviqit.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2010 në tërë Kosovën janë nënshkruar 13499 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të prokurimit.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kriterëve të shpërblimit me kontratë.


Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2010 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

2.1. NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2010

Numri i kontratave të nënshkruara			
Autoritetet kontraktuese:	Numri i kontratave 2008	Numri i kontratave 2009	Numri i kontratave 2010 ¹
Qeveritare	10882	10955	9947
Kompani publike	3431	3786	3484
Tjera	4	79	68
Gjithsej:	14317	14820	13499

Tabela 1

Analizën e kontratave të nënshkruara po e fillojmë me ndarjen e autoriteteve kontraktuese në organizata buxhetore – qeveritare, kompani publike dhe të tjera-OJQ. Dihet mirëfilli se kjo ndarje nuk e paraqet një pasqyrë reale të financimit, pasi që një numër i konsiderueshëm i kompanive publike në Kosovë financohen ende nga BKK-ja. Sido që të jetë, ne do të mundohemi, duke u bazuar në këtë ndarje, ta pasqyrojmë numrin e kontratave të nënshkruara në tabelën nr. 1 dhe në grafikonin nr. 1 gjatë tri viteve të fundit nga autoritetet kontraktuese në fjalë.



Grafikoni 1

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i paraqesin të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.


¹) Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 180 anekskontrata.

2.2. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2010

Vlera e kontratave të nënshkruara (€)			
Autoritetet kontraktuese:	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Vlera e kontratave 2010 ²
Qeveritare	456,695,720.32	529,849,302.73	286,739,192.67
Kompani publike	369,627,159.60	245,382,175.36	194,579,794.27
Tjera	160,682.75	2,922,036.94	749,861.62
Gjithsej :	826,483,562.67	778,153,515.03	482,068,848.56
Vrejtje: Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88


Tabela 2

Siq mund të vrehim nga tabela 2 kemi pasqyruar vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë tri viteve të fundit. Kontratën për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7, e nënshkruar gjatë vitit 2010 në vlerë prej 659,813,399.88€ e kemi paraqit si kontratë të veçantë pasi që kontrata në fjalë është kontratë me vlerë të madhe dhe sipas MTPT kjo kontratë është afatëgjate dhe vlera e parashikuar për vitin 2010 ishte 106,883,295.92€ të cilën po e pasqyrojmë në grafikun 2 .



Grafikoni 2


² Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera e anekskontratave në vlerë prej 7,606,594.67€



Grafikoni 2.a

Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese, si më lartë në tabelën nr.2 dhe grafikun nr. 2.a, po paraqesim vlerën e kontratave të nënshkruara, gjatë tri viteve të fundit.

Grafikoni nr. 3 e pasqyron strukturën, apo pjesëmarrjen e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010. Organizatat buxhetore - qeveritare marrin pjesë me 59.48%, kompanitë publike me 40.36%, derisa te autoritetet tjera – OJQ-të me vetëm 0.16% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara.




Grafikoni 3

2.3. VLERA E KONTRATAVE TË NËSHKRUARA GJATË VITIT 2010 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit (€)			
Burimet e financimit:	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Vlera e kontratave 2010
Të hyrat vetanake ³	145,264,989.52	178,936,718.11	149,546,783.32
Buxheti i Kons. i Kosovës	676,563,199.06	586,539,985.28	326,250,504.21
Donacione	4,655,374.09	12,676,811.64	6,271,561.03
Gjithsej :	826,483,562.67	778,153,515.03	482,068,848.56
Vrejtje: Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88

Tabela 3


Në tabelën nr.3 dhe grafikun nr.4 është pasqyruar vlera e kontratave të nënshkruara, duke pasur për bazë burimin e financimit. Nga të hyrat vetjake vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 është 149,546,783.32€. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës vlera e kontratave të nënshkruara arrin 326,250,504.21 €, derisa nga donacionet vlera e kontratave të nënshkruara arrin 6,271,561.03€.



Grafikoni 4

³ Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e kompanive publike.

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit pasqyrohet në grafikonin nr. 5, ku të hyrat vetjake marrin pjesë me 31.02%, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me 67.68 %, kurse nga donacionet me 1.30 %.




Grafikoni 5

2.4. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2010 SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit (€)			
Lloji i prokurimit:	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Vlera e kontratave 2010
Furnizim	334,982,809.59	289,392,796.00	220,318,579.03
Shërbime ⁴	44,243,562.12	62,266,651.91	59,572,746.08
Konkurs i projektimit	845,583.04	1,667,506.79	1,075,246.37
Punë	446,411,607.92	424,806,560.33	201,102,277.08
Gjithsej :	826,483,562.67	778,133,515.03	482,068,848.56
Vrejtje: Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88

Tabela 4


Bazuar në llojin e prokurimit, që kontratat kanë si objekt të tyre, në tabelën nr. 4 dhe grafikun nr. 6, vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime gjatë vitit 2010 arrin në 220,318,579.03€. Vlera e kontratave të nënshkruara për shërbime është 59,572,746.08€, kurse krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim të lehtë gjë që paraqet trendin e njëjtë me vitet paraprake, pasi që nevoja për lloje të shërbimeve të ndryshme profesionale në vendin tonë shtohet nga dita në ditë, në varësi nga trendi i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.



Grafikoni 6

⁴ Në vlerën e kontratave për shërbime janë përfshirë edhe shërbimet e konsulencës.

Vlera e kontratave të nënshkruara për konkurs projektimi është 1,075,246.37€, ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për punë arrin në 201,102,277.08€, dhe kësaj vlere nëse ja shtojm edhe vleren e Autostradës Morinë- Merdar në shumë e planifikuar për vitin 2010, krahasuar me vitin paraprak pra ky lloj i kontratave mbetet edhe më tej në trendin e njëjtë të pjesëmarrjes në vlerën e kontratave të gjithëmbarshme të nënshkruara.



Grafikoni⁵ 7

Grafikoni nr 7, paraqet strukturën, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010. Kontratat për furnizime marrin pjesë me 45,70%. Kontratat për shërbime me 12.36%, kontratat për konkurse të projektimit me 0.22 %, ndërsa kontratat për punë marrin pjesë me 41.72% .


⁵ Në grafikoni 7 , ku paraqitet struktura apo pjesëmarrja e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas llojit të prokurimit, nuk është përfshi vlera e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga7 prej 659,813,399.88€, e cila pra e shton vlerën e punëve për pjesën që është parashikuar për vitin 2010.

2.5. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2010 SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas vlerës së prokurimit (€)			
Lloji i vlerës së prokurimit:	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Vlera e kontratave 2010
Vlerë e madhe	680,198,284.54	575,602,784.31	298,457,903.83
Vlerë e mesme	119,156,951.86	171,592,255.32	156,188,246.69
Vlerë e vogël	23,599,031.30	27,080,232.79	24,490,421.94
Vlerë minimale	3,529,294.97	3,878,242.61	2,932,276.10
Gjithsej :	826,483,562.67	778,153,515.03	482,068,848.56
Vrejtje: Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88


Tabela 5

Kontratat e nënshkruara, të ndara sipas llojit të vlerave të kontratave, në tabelën nr. 5 dhe në grafikun nr. 8, na pasqyrojnë se, sipas vlerës së madhe, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 është 298,457,903.83€.



Grafikoni 8

Kontratat e nënshkruara me vlerë të mesme arrijnë shumën prej 156,188,246.69€, vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 24,490,421.94€. Vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë minimale është 2,932,276.10€.



Grafikoni 9

Në bazë të grafikomit nr. 9 vërehet se pjesëmarrja e kontratave me vlera të mëdha, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010, është 61.91%. Kontratat me vlera të mesme marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 32.40%. Kontratat me vlerë të vogël marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 5.08%, derisa kontratat me vlerë minimale marrin pjesë me 0,61 %.

2.6. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITEVE 2008, 2009 DHE 2010 SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit (€)			
Lloji i procedurave:	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Vlera e kontratave 2010
Procedurë e hapur	639,679,203.78	660,305,834.65	412,030,313.41
Procedurë e kufizuar	0.00	0.00	0.00
Konkurs projektimi	845,583.04	1,687,506.79	1,075,246.37
E negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës	31,305,268.41	3,027,620.00	9,791,913.24
E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	132,851,422.20	84,235,456.82	33,837,639.27
Kuotimi i çmimeve	18,288,457.42	25,078,675.39	22,403,715.17
Procedurë për vlerë minimale	3,513,627.82	3,818,421.38	2,930,021.10
Gjithsej :	826,483,562.67	778,153,515.03	482,068,848.56
Vrejtje ⁶ :Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88

Tabela 6


Analiza e kontratave të nënshkruara, të ndara sipas llojit të procedurave në tabelën nr. 6 dhe në grafikun nr.10, tregon se vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2010 është 412,030,313.41€. Sipas procedurës së kufizuar gjatë vitit 2010 autoritetet kontraktuese nuk kanë paraqitur prokurime.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi, gjatë vitit 2010, është 1,075,246.37€, derisa vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës, gjatë vitit 2010, është 9,791,913.24€. Kurse sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës është 33,837,639.27€ dhe vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve, gjatë vitit 2010, është 22,403,715.17€.

Ndërkaq, sipas procedurës për vlerë minimale, vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë vitit 2010, është 2,930,021.10€

⁶ Kjo kontratë është nënshkruar gjatë vitit 2010, Procedura e negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës.


Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit gjatë viteve 2008,2009 dhe 2010



Grafikoni 10

Analiza e strukturës, apo e pjesëmarrjes së procedurave të zbatuara gjatë vitit 2010, në grafikonin nr. 11, na pasqyron se pjesëmarrja e procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 85.47%, e cila është nga procedurat e përdorura më së shumti dhe e njohur si procedura më transparente.

Gjithsejt - Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas procedurave të prokurimit




Grafikoni 11

Gjithashtu, edhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës është 2.03%. Dhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikimit të njoftimit të kontratës gjatë vitit 2010 është 7.02%, e cila procedurë pra ka shënuar një zvogëlim të theksuar krahasuar me vitet paraprake.

Derisa gjatë vitit 2008 kjo pjesëmarrje ishte 16.07%, gjatë vitit 2009 ishte 10.83%, dhe gjatë vitit 2010 kjo pjesëmarrje ka rënë në 7.02%. Shumë kështu shihet se pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikimit të njoftimit të kontratës është në zvogëlim sipër, kjo tregon për një trend mjaftë pozitiv rreth përdorimit të procedurave të prokurimit.

Derisa pjesëmarrja e procedurave sipas kufizimit të çmimeve është 4.60% dhe sipas vlerës minimale merr pjesë me 0,61 %, kurse konkursi i projektimit marrin pjesë vetëm me 0,22 % në vlerën e kontratave të gjithëmbarshme të nënshkruara gjatë vitit 2010.


Prandaj, mund të konstatohet se përdorimi i procedurës së hapur si edhe zvogëlimi në vazhdim i përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, janë indikatorë mjaftë shprehësive për prokurimin publik, për ekonominë Kosovare dhe të ardhmen e saj drejt integriteteve të BE-së.



Grafikoni 11. a


Grafikoni 11.a pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit të organizatave buxhetore apo Qeveritare. Derisa grafikoni 11.b pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit të Kompanit Publike dhe grafikoni 11.c paraqet përdorimin e procedurave të prokurimit të organizatave tjera- OJQ-të.

Kompani publike-pjesëmarrja në vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas procedurave të prokurimit



Grafikoni 11.b

Tjera/OJQ-pjesëmarrja në vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 sipas procedurave të prokurimit




Grafikoni 11 c

2.7. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2010 SIPAS LLOJIT DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas llojit dhe procedurave të prokurimit 2010 (€)							
Lloji prokurimit	E hapur	Konkurs projektimi	E negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës	E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	Kuotim i çmimeve	Procedur vlera minimale	Gjithsej:
Furnizim	183,726,172.22	-	5,744,841.56	13,189,885.60	15,508,449.22	2,149,230.43	220,318,579.02
Shërbime	32,508,238.82	-	4,047,071.68	15,656,649.68	6,585,788.24	774,997.67	59,572,746.09
Konkurs projektim	-	1,075,246.37	-	-	-	-	1,075,246.37
Punë	195,795,902.38	-	-	4,991,103.99	309,477.71	5,793.00	201,102,277.08
Gjithsej	412,030,313.42	1,075,246.37	9,791,913.24	33,837,639.27	22,403,715.17	2,930,021.10	482,068,848.56
Vrejtje: Kontrata e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88				

Tabela 7

Në tabelën nr. 7 dhe grafikonin nr. 12 kemi të pasqyruar vlerën e kontratave të nënshkruara sipas llojit dhe ndërthurjen e tyre me vlera të kontratave sipas procedurave të prokurimit gjatë vitit 2010. Këtu, pra, pasqyrohet secili lloj i prokurimit ndaj procedurës së zbatuar të prokurimit.



Grafikoni 12

2.8. KONTRATAT E NËNSHKRUARA DHE ANEKSKONTRATAT

Vlera e kontratave të nënshkruara dhe anekskontratave gjatë vitit 2009 dhe 2010 (€)				
Kontratat:	Vlera e kontratave 2009 (€)	Pjesmarrja 2009 %	Vlera e kontratave 2010 (€)	Pjesmarrja 2010 %
Kontratat e nënshkruara	769,766,186.86	98.92	474,462,253.89	98.42
Anekskontratat	8,387,328.16	1.08	7,606,594.67	1.58
Gjithsej :	778,153,515.02	100.00	482,068,848.56	100.00
Vrejtje:Kontrata e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88	

Tabela 9

Siç shihet nga tabela e mësipërme nr.9, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 është 474,462,253.89€, me një pjesëmarrje prej 98.42% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara, kurse vlera e anekskontratave arrin në 7,606,594.67€, apo me pjesëmarrje 1.58% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 474,462,253.89€ .


2.9. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË DHE JOVENDORË

Vlera e kontratave të nënshkruara OE vendorë – jovendorë gjatë vitit 2008,2009 dhe 2010 (€)			
Operatorët ekonomik:	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Vlera e kontratave 2010
Operatorët vendor	587,017,393.58	665,339,300.78	382,871,695.74
Operatorët jovendor	239,466,169.09	112,814,214.24	99,197,152.82
Gjithsej :	826,483,562.67	778,153,515.02	482,068,848.56
Vrejtje:Kontrata e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88

Tabela 10

Nga analiza e bërë e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010, të ndara sipas shpërblimit me kontratë në operator ekonomik vendor dhe jovendor, në tabelën 10, grafikonin 13, del se vlera e kontratave të dhëna operatorëve vendor është 382,871,695.74 €, kurse pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 është 79.42%. Derisa vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010 nga operatorët jovendor është 99,197,152.82€ dhe me pjesëmarrje prej 20.58% në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010.

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas operatorve ekonomik vendorë - jo vendorë gjatë vitit 2010



Grafikoni 13

2.10. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR PËR PUBLIKIM

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor të publikimit gjatë vitit 2009 dhe 2010 (€)				
Afatet e publikimit:	Vlera e kontratave 2009	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2010	Pjesëmarrja %
Afate normale kohore	587,807,910.50	75.54	387,245,825.97	80.33
Shkurtim i afatit	190,345,604.53	24.46	94,823,022.59	19.67
Gjithsej :	778,153,515.03	100.00	482,068,848.56	100.00
Vrejtje: Kontrata e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88	

Tabela 11

Të dhënat në tabelën nr. 11, vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese me afate normale kohore është 387,245,825.97€ dhe me pjesëmarrje prej 80.33 % në vlerën e gjithëmbarshtëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010. Kurse vlera e kontratave të nënshkruara të publikuara me afat të shkurtuar arrin në 94,823,022.59€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 19.67% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010.


2.11. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE KONTRATE

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie gjatë vitit 2009 dhe 2010 (€)				
Kriteret për dhënie kontrate:	Vlera e kontratave 2009	Pjesëmarrja 2009 (%)	Vlera e kontratave 2010	Pjesëmarrja 2010 (%)
Çmimi më i ulët	420,712,646.21	54.07	406,682,846.64	84.36
Çmimi ekonomikisht më i favorshëm	357,440,868.82	45.93	75,386,001.92	15.64
Gjithsej :	778,153,515.03	100.00	482,068,848.56	100.00
Vrejtje: Kontrata e Autostradës Morinë-Merdare, Rruga 7			659,813,399.88	

Tabela 12

Siç shihet në tabelën nr. 12 vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, sipas kriterit për dhënie çmimi më i ulët, është 406,682,846.64€, me pjesëmarrje prej 84.36 % në vlerën e gjithëmbarshtë të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010. Ndërkaq, vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie çmimi ekonomikisht më të favorshëm arrin në 75,386,001.92€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 15.64% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2010.

2.12. NUMRI MESATAR I TENDERUESËVE QË KAN KONKURUAR PËR NJË PROKURIM GJATË VITIT 2010




Grafikoni 13.a

2.13. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË RAPORT ME BPV NË KOSOVË GJATË VITIT 2010

Vlera e përgjithshme e prokurimeve publike gjatë vitit 2010, është 482,068,848.56€, gjë që paraqet 11.78 % të BPV (bruto produkti vendor në vitin 2010 në Kosovë = 4,092,000,000.00 €).⁷ Grafikoni 14 në vazhdim paraqet këtë pjesëmarrje.


Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara në Bruto Produktin Vendor gjatë vitit 2010



Grafikoni 14

Në grafikonin 14.a pasqyrohet pjesëmarrja e kontratave të nënshkruara bashkë me vlerën e parashikuar për vitin 2010 të Autostraden Morinë – Merdar (482,068,848.56€ + 106,883,295.92€) në BPV.

Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara në Bruto Produktin Vendor gjatë vitit 2010



Grafikoni 14. a

⁷ Burimi : Departamenti i Makroekonomisë - MEF

2.14 NUMRI DHE VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË KOSOVË NGA AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2010

Nr	Autoritetet Kontraktuese	Nr i kontratave ⁸	Vlera e kontratave (€)	Pjesëmarrja (%)
1	Administrata Tatimore e Kosovës	65	1,258,339.96	0.26
2	Aeroporti Nderkombetar i Prishtinës Adem Jashari	132	2,644,915.21	0.55
3	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	36	137,146.89	0.03
4	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	63	827,168.82	0.17
5	Agjencia Kadastrale e Kosovës	15	720,538.68	0.15
6	Agjencia Kosovare e Privatizimit	68	2,192,168.89	0.45
